

VENDIM
Nr. 104, datë 14.4.2026

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “GSA” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 275/10 prot., datë 10.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GSA’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., në datën 26.2.2026, ka paraqitur aplikimin e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 70, datë 10.3.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.3.2026 dhe 12.3.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.3.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 275/6 prot., datë 12.3.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj dhe informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet në aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 275/7 prot., datë 19.3.2026, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacionin/informacionin plotësues, nga i cili rezultonte se kishte ende dokumentacion që nevojitej të plotësohej, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me *email*-in nr. 175/8 prot., datë 7.4.2026.

- Në përgjigje, me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 275/9 prot., datë 8.4.2026, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të munguar dhe në lidhje me dokumentacionin e mbetur për mbështetjen financiare ka kërkuar mundësinë për të paraqitur këtë dokument brenda majit prill 2026. Kjo dhe në rrethanat kur shoqëria ka një licencë të vlefshme deri në qershor të vitit 2026.

Zgjatja e vendimmarrjes:

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.”.

- Për sa më lart referuar, si dhe kërkesës së shoqërisë, vlerësohet që të zgjatet afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s deri në 30 (tridhjetë) ditë për aplikimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë

në ERE, brenda 20 (njëzet) ditëve, dokumentacionin plotësues, në lidhje me dedikimin e fondeve për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për licencim veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin plotësues, në lidhje me dedikimin e fondeve për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “GSA” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti